

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR PYJET”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji i propozuar ka si qëllim miratimin e kuadrit të ri rregullator bazë për pyjet, në përputhje dhe në zbatim të politikave afatgjata për pyjet në Shqipëri (me kohështirje 2019-2030), përgatitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me mbështetjen e qeverisë suedeze që ka mbështetur projektin “Mbi kuadrin rregullator të sektorit të pyjeve”, i cili konsistonte në hartimin/miratimin e dokumentit të politikave për pyjet si dhe, aktualisht, të ligjit të ri sektorial për pyjet.

Projektligji propozohet për arsyet, si më poshtë vijon:

- a) Garantimin e qeverisjes dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor kombëtar;
- b) Një përafrim maksimal të legjislacionit të BE-së në sektorin pyjor;
- c) Dokumenti i politikave për pyjet duhet të pasohet nga ligji i ri sektorial për pyjet;
- ç) Ligji aktual nuk mundëson zbatimin e plotë të politikave të reja për pyjet në Shqipëri, 2019-2030, ndaj kjo paraqet nevojën e miratimit të një ligji të ri. Kjo edhe pasi dispozitat që do të prekeshin janë të shumta (mbi 50%) dhe rrjedhimisht për efekt të teknikës legjislative, zgjidhet ky opsion. Për më tepër, që me ligjin aktual sektori shfaqet me shumë problematika dhe trend negativ të gjendjes së pyjeve dhe fondit pyjor kombëtar, për të ardhmen, ndaj minimalisht mosrishikimi i tij nuk ka gjasa që të sjellë përmirësim të gjendjes në cilindo aspekt të sektorit të pyjeve, por një vazhdim të përkeqësimit të situatës dhe të degradimit të fondit pyjor siç ka ndodhur tashmë gjatë gjithë periudhës së funksionimit të ligjit aktual;
- d) Garantimi i kuptueshmërisë, qartësisë, harmonizimit dhe logjikës juridike të dispozitave adreson domosdoshmërisht nevojën e hartimit të një ligji të ri. Kjo edhe sepse ligji aktual nuk adreson apo rregullon në mënyrën e duhur çështjet dhe problematikat aktuale me të cilat përballet sot sektori;
- dh) Përcaktimi i rolit dhe i përgjegjësiwe funksionale për të gjitha institucionet përgjegjëse për pyjet, në nivel qendror dhe vendor, tashmë

edhe me ngritjen e AKP-së, mund të parashikohet nga dispozita autorizuese e përcaktuar vetëm me ligjin e ri.

Për më tepër, synohet edhe përafrimi i dy rregulloreve për shitjen e lëndës drusore dhe produkteve të tij në tregun e Bashkimit Evropian.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet të arrihen ruajtja, shtimi i sipërfaqes dhe rritja e volumit të përgjithshëm të fondit pyjor kombëtar, organizimi funksional në të gjitha nivelet e qeverisjes, shfrytëzimi dhe përdorimi i qëndrueshëm dhe i balancuar i burimeve pyjore përkundrejt mundësisë që pyjet kanë, pa cenuar vazhdueshmërinë e jetës dhe ciklin e pyllit, si dhe garantimin e shërbimeve cilësore duke synuar mbrojtjen e duhur, përmirësimin dhe rigjenerimin e hapësirës pyjore.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave, për katërmujorin e tretë të vitit 2019.

Gjithashtu, për sa i përket lidhjes me programin qeverisës 2017-2021, përcaktohet pika 2.4, “Mjedisi”, fq.12.

Edhe në raport me PKIE-në 2019-2021, ndër prioritetet për kapitullin 27-“Mjedisi”, përfshihet edhe miratimi i projektligjit të ri për pyjet.

Përveç sa më sipër, qeverisja e sektorit të pyjeve gjen mbështetje dhe është në një linjë me përcaktimet/drejtimitet e dhëna nga dokumente të tjera për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, si SKZHI-ja 2020, dokument kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, duke siguruar përmbushjen e standardeve dhe progresin në procesin e integritetit evropian. Gjithashtu, projektligji është hartuar në përputhje me parashikimet e dokumenteve sektoriale që ndërthuren me pyjet, të tilla si Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2020, për mbrojtjen e biodiversitetit 2020, Strategjia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2020, Strategjia e Energjisë 2030, PKV-ja për burimet e energjisë së rinovueshme 2020, Strategjia e Zhvillimit të Turizmit 2023, Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2027, Strategjia për Ndryshimin e Klimës 2020/2030/2050, Strategjia për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2020, Strategjia Ndërsektoriale për Reformën e Administratës Publike 2020, programimi buxhetor specifik në PBA-në 2020-2022, për zonat e mbrojtura 2020, PPK-ja e territorit 2030, PIN-ja bregdeti 2020 etj., si dhe duke respektuar angazhimet ndërkombëtare dhe përafrimin me BE-në.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nisur nga situata ekzistuese e sektorit të pyjeve, e cila paraqitet e cunguar, dhe ku sektori i pyjeve ka qenë vazhdimisht objekt ndryshimesh të shpeshta (edhe si rezultat i reformave të ndryshme qeverisëse si ajo territoriale, decentralizimi, institucionale etj.) rezulton se Shqipëria renditet si një vend me volum të varfër në pyje. Planet e mbarështimit mungojnë ose u ka mbaruar afati i veprimit (aktualisht nuk ka asnjë plan mbarështimi nga 364 ekonomi pyjore), kurse projektet e zhvillimit janë të pakta ose jofizibël, për shkak të trajtimit të copëzuar apo të paintegruar.

Ligji për pyjet dhe shërbimin pyjor ka pësuar 7 ndryshime që nga momenti i miratimit në 2005, duke shkaktuar edhe pasiguri juridike. Gjithashtu, është bërë decentralizimi i qeverisjes së pyjeve, ku, aktualisht, janë 61 bashki që kanë marrë në pronësi pyje dhe kullota publike, ndërkohë që 15% e fondit pyjor është përfshirë si zonë e mbrojtur nën AKZM. Në janar të vitit 2016 u miratua moratoriumi i pyjeve, për të frenuar situatën e shkatërrimit të pyjeve. Për të frenuar këtë trend negativ të zhvillimit të pyjeve u miratua dokumenti i politikave për pyjet 2019-2030, si dhe propozohet miratimi i këtij projektligji për të mundësuar rregullimin e duhur kuadër për sektorin.

Të rejat që synon të sjellë miratimi i këtij projektligji, duke i grupuar sipas 4 synimeve strategjike të përcaktuara në dokumentin e politikave për pyjet 2030, në mënyrë të përmbledhur paraqiten, si më poshtë vijon:

- Synimi strategjik 1 “Administrimi i mirë”;
- Synimi strategjik 2 “Organizim funksional”;
- Synimi strategjik 3 “Shfrytëzim i qëndrueshëm”;
- Synimi strategjik 4 “Shërbime cilësore”.

Nëpërmjet projektligjit synohet mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës dhe të tokës, në ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrime me interes kombëtar dhe ndërkombëtar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, dhe 100 të Kushtetutës, ku në pikën 1, të nenit 83, përcaktohet se: “*Të drejtën për të*

propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave; Këshilli i Ministrave merr vendime me propozim të Kryeministrit ose të ministrit përkatës;...”

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BE-SË (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky ligj dhe në veçanti, dispozitat për shitjen e lëndës drusore dhe të produkteve të tij në tregun e BE-së (të trajtuar në projektligj respektivisht në pikat 16 dhe 17, të nenit 4, si dhe në nenin 25), përfron pjesërisht rregulloren e Këshillit (KE) nr.2173/2005, 20 dhjetor 2005, “Për ngritjen e një skeme licencimi FLEGT për importin e drurit në Komunitetin Evropian”, CELEX_32005R2173, OJ L 347, 30.12.2005, p. 1-6, pjesërisht rregulloren (BE) nr.995/2010, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, 20 tetor 2010, që përcakton detyrimet e operatorëve, të cilët vendosin dru/lëndë druri dhe produkte druri në treg, CELEX_32010R0995, OJ L 295, 12.11.2010, p. 23-34 dhe pjesërisht rregulloren nr.607/2012, të datës 6 korrik 2012.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përbëhet nga 41 nene, të strukturuar në 8 krerë.

Kreu I trajton dispozitat e përgjithshme, në 3 nene, që i referohen: qëllimit të ligjit; objektit dhe fushës së zbatimit, si dhe listimit dhe shpjegimit të 61 përkufizimeve, termave apo koncepteve të përdorura në projektligj, që do të lehtësojnë kuptueshmërinë e tij.

Kreu II lidhet me përcaktimet për sektorin e pyjeve, që përfshin 6 nene dhe që parashikojnë rregullime mbi: klasifikimin e pyjeve dhe të fondi pyjor kombëtar (FPK), kufijtë dhe ndryshimet në FPK, përcaktimet mbi Regjistrin Kombëtar, Inventarizimin dhe Rrjetin e Monitorimi të FPK-së, grupet kryesore të interesit në sektorin e pyjeve, qeverisjen e sektorit të pyjeve, parimet kryesore dhe vlerat bazë; si dhe për politikën dhe Programin Kombëtar të Pyjeve.

Kreu III është administrimi i sektorit të pyjeve. Në këtë kre të strukturuar mbi bazën e tre neneve, përkatësisht nenet 10, 11 dhe neni 12, jepen koncepte ligjore mbi mbarrësimin e pyjeve, të drejtat dhe detyrimet mbi pyjet dhe financimin e sektorit të pyjeve.

Mbarësimi i pyjeve është dokumenti themeltar i synimit të qeverisjes së qëndrueshme të fondit pyjor. Në këtë nen parashikohen afatet kohore të një plani mbarrësimi, mënyra e hartimit të tij, procedurat e miratimit dhe për parimet e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje. Në nenin 11 trajtohen

problemet që lidhen me të drejtën e pronësisë mbi FPK, të drejtën e shfrytëzimit dhe të përdorimit si dhe rregulla e kritere mbi të cilat ndërtohen këta principe.

Kreu IV është organizimi i sektorit të pyjeve dhe i referohet synimit strategjik 2 “Organizim funksional” të përcaktuar në dokumentin e politikave për pyjet 2019-2030, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Nenet e kreut IV ndërthuren me tri politikat për sistemin e pyjeve që lidhen me synimin afatgjatë 2 “Organizim funksional”, si më poshtë:

Neni 13 trajton institucionet qendrore përgjegjëse për pyjet, ministrinë përgjegjëse për pyjet dhe Agjencinë Kombëtare të Pyjeve dhe strukturat vendore përgjegjëse për pyjet, ku si risi e këtij projektligji konsiderohen ngritja e strukturave komunitare në fshat, të cilat do të kujdesen për përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve në zonën e tyre.

Neni 17, mbi profesionistët e pyjeve, trajton probleme të cilat garantojnë profesionalizmin në këtë sektor, duke u mbështetur edhe në kritere cilësore dhe sasimore mbi të cilat duhet të bëhet rekrutimi i tyre. Në këtë nen janë parashikuar roli dhe përgjegjësitë e çdo institucioni përgjegjës në fushën e pyjeve, si dhe është përcaktuar në mënyrë të qartë kriteri i profesionalizmit si dhe arsimimi përkatës në fushën e pyjeve të personave të përfshirë në sektorin e pyjeve.

Gjithashtu, në përputhje me politikat e qeverisë në fushën e barazisë gjinore është vënë në dukje respektimi i raportit gjinor në emërimin e stafit në instituconet përgjegjëse të kësaj fushe. Gjithashtu, në funksion të rekrutimit të një stafi sa më profesional është parashikuar që emërimi në detyrë i strukturave përgjegjëse në pyje në bashki të bëhet nga kryetari i bashkisë.

Neni 19 rregullon kërkimin shkencor në FPK.

Neni 20 përcakton sistemin e integruar të informacionit në pyje.

Neni 21 shtjellon dispozitat mbi infrastrukturën në pyje.

Kreu V i referohet përfitimeve nga shfrytëzimi i fondit pyjor kombëtar, duke qenë në zbatim të synimit strategjik 3 “Shfrytëzim i qëndrueshëm” të përcaktuara në dokumentin e politikave për pyjet 2019-2030. Nenet e kreut V ndërthuren me tri politikat për menaxhimin, shfrytëzimin, përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve, që lidhen me synimin afatgjatë 3 “Shfrytëzim i qëndrueshëm”, si më poshtë:

Neni 22 trajton kategoritë e përfitimeve dhe rregullat mbi shfrytëzimin e FPK-së.

Neni 23 i referohet përcaktimeve për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve në ekosistem.

Neni 24 mbi përfitimin nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në FPK.
Neni 25 rregullon përfitimin nga shfrytëzimi i produkteve jodrusore nga pylli.
Neni 26 përcakton përfitimin nga shfrytëzimi i produkteve drusore.
Neni 27 shtjellon dispozitat mbi shitjen e lëndës së drurit dhe të produkteve të tij në tregun e BE-së, i cili konsiderohet si një hap për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë evropian në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE.

Kreu VI lidhet me trajtimin dhe shërbimet ndaj pyjeve dhe është në përputhje me synimin strategjik 4 “Shërbime cilësore”, të përcaktuara në dokumentin e politikave për pyjet 2019-2030. Nenet e kreut VI ndërthuren me tri politikat për kujdesin dhe shërbimin ndaj pyjeve, që lidhen me synimin afatgjatë 4 “Shërbime cilësore”, si më poshtë:

Konkretisht, në kreun VI të projektligjit, neni 28 trajton elementet e shërbimit ndaj FPK-së.

Neni 29 i referohet përcaktimeve për mbrojtjen e FPK-së.

Neni 30 detajon rregullat për përmirësimin e FPK-së.

Neni 31 përcakton dispozitat mbi prerjet në FPK.

Neni 32 shtjellon përcaktimet mbi rigjenerimin e FPK-së.

Kreu VII i referohet kontrollit dhe kundërvajtjeve në sektorin e pyjeve. Edhe ky kre ndërthuret me zbatimin e politikës nr.10 “Mbrojtja e pyjeve”, që trajton forcimin e masave sinjalizuese dhe parandaluese për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri, masat ndëshkuese për prerjen, transportin dhe shitjen e paligjshme të lëndës drusore etj. Konkretisht, në kreun VII të projektligjit, neni 33 trajton kontrollin e veprimtarive në fondin pyjor kombëtar (FPK), duke specifikuar rolin dhe përgjegjësinë e çdo strukture, si në nivelin vendor, nëpërmjet strukturës përkatëse në bashki, ashtu edhe në nivelin qendror, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Pyjeve dhe strukturës përgjegjëse për zonat e mbrojtura që janë në varësi të ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura. Gjithashtu, është parashikuar edhe roli i Policisë së Shtetit në parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale në fushën e pyjeve.

Neni 35 i referohet përcaktimeve për kundërvajtjet administrative në FPK, duke specifikuar shkeljen dhe gjobën për secilën shkelje. Në këtë nen është parashikuar si risi edhe dënimi me gjobë të strukturave dhe personave të institucioneve që lidhen me fondin pyjor, në rast kur ata veprime apo mosveprime nuk zbatojnë përgjegjësitë ligjore të parashikuara në këtë ligj.

Neni 36 detajon përgjegjësinë për dëmet në FPK.

Neni 37 shtjellon përcaktimet mbi procedimin në FPK, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative dhe inspektimin.

Kreu VIII trajton dispozitat kalimtare dhe të fundit, ku neni 38 detajon shfuqizimet, marrëdhëniet me ligjet e tjera dhe aktet nënligjore.

Neni 39 rregullon dispozitat kalimtare që lidhen me miratimin e këtij projektligji.

Në nenin 40 detajohen të gjitha detyrimet për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit, përkatësisht nga Këshilli i Ministrave, ministri i Turizmit dhe Mjedisit, dy ministrat e tjerë të MFE-së dhe MSHMS-së, si dhe AKP-ja.

Neni 41 dhe i fundit i projektligjit rregullon përcaktimet standard mbi hyrjen në fuqi të ligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Me zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe strukturat përgjegjëse për pyjet në ministri, ministri i Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme, AKP (Agjencia Shtetërore Përgjegjëse për Pyjet), Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura/AdZM, njësitë e vetëqeverisjes vendore/strukturat e tyre, grupet e interesit etj.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji vjen si propozim i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit. Ai është hartuar nga një grup pune ministror dhe ka kaluar në një proces të gjerë diskutimesh dhe konsultimi me një sërë takimesh të veçanta me aktorët e sektorit, duke nisur nga tremujori i fundit i vitit të kaluar. Për këtë qëllim janë shfrytëzuar edhe konsultimet e realizuara në kuadër të projektit për reformën rregullatore në pyje (me komponent dokumentin e politikave për pyjet dhe projektligjin e ri sektorial), duke përfshirë 4 seminarët rajonale në Shkodër, Korçë, Kukës, Fier dhe takimin final në Tiranë, prej të cilave u morën komentet dhe sugjerimet kryesore nga NjVV-të dhe AdZM-të, në lidhje me rolin e tyre të ri dhe të fuqizuar për të përmirësuar situatën në pyje dhe veçanërisht efikasitetin e kontrollit dhe inspektimit, që tashmë propozohen të miratohen me këtë projektligj.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatueshmëria e projektligjit do të mundësohet nga PBA-ja 2020-2022, Banka Botërore dhe SIDA, donatorë dhe sipërmarrës të tjerë, si dhe nga kostot minimale të lidhura kryesisht me procesin.

Lidhur me programin e administrimit të pyjeve që lidhet edhe me zbatimin e ligjit të ri për pyjet, në PBA 2020-2022 (miratuar me vendimin nr.588, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e projektdokumentit të

programit buxhetor afatmesëm 2020–2022” dhe botuar në “Fletoren zyrtare”, nr.127, datë 16.9.2019), janë parashikuar disa produkte/projekte me buxhetin e tyre përkatës të shtrirë në vite, duke nisur nga buxheti i vitit aktual 2019 e deri me projeksionin e viteve 2020, 2021 dhe 2022. Kryesisht këto produkte dhe projekte i referohen hartimit të planeve të mbarështimit për zonat e mbrojtura në masën 90% dhe për fondin pyjor publik në masën 100%, ngritjes së sistemit të informacionit digjital ALFIS (dizenjimi, metodologjia, vënia në funksionim e *software* dhe krijimi i një databaze të re të kadastrës së fondit pyjor publik, i lidhur me sistemin GIS, mbështetur nga Banka Botërore dhe SIDA), regjistrimit të fondit pyjor (vlerësimi i dokumentacionit ligjor dhe i gjendjes për zonat e përcaktuara, përgatitja e hartës digjitale dhe kartelës për sipërfaqet e regjistruara, integrimi i tyre dhe databazës së ish-ZRPP apo ASHK), realizimit të raporteve të monitorimit në zonat e mbrojtura dhe planifikimit të menaxhimit, kostot për inventarizimin kombëtar të pyjeve, modelet hidrologjike dhe krijimi i mekanizmave të financimit për të zvogëluar degradimin e tokës, sistemit elektronik të monitorimit të pyjeve (përmirësimi i cilësisë së shërbimit për parandalimin e kundërvajtjeve për prerjen e pyjeve), ndërgjegjësimit publik, planit gjinor të veprimit, projekti i shërbimeve mjedisore (TVSH).

Gjithashtu, është parashikuar kryerja e inspektimeve (referuar subjekteve që ushtrojnë aktivitete në fondin pyjor, të klasifikuar si aktivitete me risk të lartë, për uljen e paligjshmërisë në aktivitetin ekonomik të tyre dhe kthimin në normalitet të ekuilibrave të prishur në pyje, dhe të marrjes së vlerave të tyre për plotësimin e nevojave ekonomike të shoqërisë).

Nga vlerësimi evidentohet se miratimi dhe zbatimi i këtij projektligji nuk do të sjellë impakt të konsiderueshëm në shpenzimet buxhetore të shtetit. Ndërkohë që me rregullimin e ri ligjor synohet administrimi më i mirë i sektorit dhe fondit pyjor kombëtar, duke pasur si pritshmëri për të ardhmen mundësimin e efekteve financiare pozitive në sektor.

KËSHILLI I MINISTRAVE